



AGJENCIA SHITETËRORE E ARKIVAVE E KOSOVËS

***KATALOGU
I EKSPozITËS***

BËJE OSE VDIS

Kushtuar jetës dhe veprës së Ukshin Hotit

Prishtinë, 2021

AGJENCIA SHETETËRORE E ARKIVAVE E KOSOVËS

Botime të veçanta

**KATALOGU
I EKSPozITËS**

BËJE OSE VDIS!

Kushtuar jetës dhe veprës së Ukshin Hotit

Prishtinë, 2021

Botues

Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës

Kryeredaktor i botimit

Bedri Zyberaj

Përgatiti

Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës

Redaktor gjuhësor

Berat Dakaj

Redaktor teknik

Bekim Aliu

Tirazhi

100 copë



AGJENCIA SHETETËRORE E ARKIVAVE E KOSOVËS

KATALOGU

BËJE OSE VDIS

Kushtuar jetës dhe veprës së Ukshin Hotit

Prishtinë, 2021

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës“Pjetër Bogdani”

323.28(496.51)(092)(084.12)

929(=18:496.51)Hoti, Ukshin

Bëje ose vdis : katalog i ekspozitës / Kryeredaktor i botimit Bedri Zyberaj ; përgatiti Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. - Prishtinë : Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës, 2021. - 26 f. : ilustr. ; 27 cm.

Hoti, Ukshin 1943 -- Biografia -- Veprimtaria politike dhe shoqërore

Krimet dhe shkeljet politike -- Kosovë -- Katalogët e ekspozitave
Kosova -- Historia -- Persekutimi politik, terrorizmi

ISBN 978-9951-404-55-6

Aleph [000098408]

BËJE OSE VDIS!

I

11 mars 1981. Deri në mbrëmjen e kësaj date, në hapësirën e trojeve shqiptare në ish -Jugosllavinë federale, dukej sikur çdo gjë kishte arritur një harmoni të përkryer dhe mbretëronte një qetësi reale.

Në mbrëmjen e asaj nate, në Mensën e studentëve të Universitetit të Prishtinës, kishte shpërthyer një pakënaqësi sociale. Në fakt ajo kishte qenë riaktivizim i një vullkani të fjetur, llava e të cilit, me 26 mars, kishte vërshuar rrugëve të Prishtinës, me ç'rast, i ishin bashkuar sidomos rinia shkollore e asaj kohe, për t'u bërë, me 1 e 2 prill, edhe më gjithëpërfshirëse edhe më të fuqishme.

Kundëreagimi i shtetit kishte qenë i ashpër me veprime të dhunshme për shtypjen e revoltës dhe sidomos iracionale me vlerësimin politik të kërkesës thelbësore që ishte artikuluar me atë rast për statusin e ish-Krahinës së Kosovës që të avancojë në status të Republikës.

Gjithandej hapësirës së kësaj krahine, nëpër qytete dhe fshatra, nëpër organizata punuese e organizata politike, njësi akademike të Universitetit të Prishtinës e institucione shkollore e shkencore si dhe në çdo njësi tjetër organizative, ishin ndërmarr veprime politike të natyrës policore, për shpjegimin e karakterit „armiqësor” të demonstratave dhe kërkesës së tyre për Republikë.

Përballë këtij imponimi politik nga lart, për t'i dënuar demonstratat, demonstruesit dhe kërkesën për Republikë, njerëzit, nga frika ishin tulatur në fshehtësinë e vet dhe kishin gjykuar se më e përshtatshme ishte heshtja. Për ta dënuar kërkesën për Republikën nuk ua donte shpirti. Atë që ua donte shpirti nuk kishin guxim ta thoshin. Prandaj, kishin zgjedhur të heshtnin e të mbylleshin në guacën e heshtjes së vet.

Kështu nuk kishte ndodhur me të gjithë.

Ndër më të shquarit që nuk kishte heshtur ishte Mr. Ukshin Hoti, prof. në Universitetin e Prishtinës, i cili i ishte kundërvënë fushatës demonizuese të studentëve dhe demonstratave të tyre. Ai i ishte kundërvënë sidomos fushatës së vlerësimit të kërkesës fundamentale të atyre demonstratave në njërën nga mbledhjet e Organizatës Themelore të LKJ-së të Fakultetit Filozofik, duke e kundërshtuar gjykimin apriori të kërkesave të studentëve, sipas diktatit të organeve të larta politike dhe shtetërore. Në kundërshti me qasjen e tillë që tani më, nga ato organe, ishte hartuar si Platformë politike e LKJ-së për luftimin e „nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptarë”, Ukshin Hoti kishte kërkuar, që në vend të gjykimit dhe dënimit të hapet debati për kërkesat e studentëve dhe të bëhen analiza shkencore dhe politike mbi bazën e argumenteve rreth atyre kërkesave. Për më tepër, aty shpreh mendimin se Kosova e meriton dhe duhet të avancohet statusi i saj nga ai i Krahinës që e kishte në statusin e Republikës gjë e cila do ta barazonte atë (Kosovën) me 6 republikat tjera që i kishte Federata e Jugosllavisë e asaj kohe.

Për këtë arsye, Mr. Ukshin Hotin e arrestojnë me 24 dhjetor 1981, dhe pas një procesi gjyqësor, Gjykata e Qarkut e Prishtinës, më 22 korrik 1982, e dënon me 9 vjet burg. Përveç tij, më atë rast dënohen edhe Mr. Halil Alidema, me 11 vjet burg, Ekrem Kryeziu, me 8 vjet, Mentor Kaçi me 7 vjet, Hilmi Ratkoceri me 3 vjet, Ali Kryeziu me 5 vjet, Nezir Haliti me 2 vjet, Shemsi Reçica me 7 vjet dhe Muharrem Fetiu me 6 muaj burg.

Pas ankimit të këtij vendimi të Gjykatës së Qarkut, Gjykata Supreme e Kosovës, Mr. Ukshin Hoti, do t'ia ndryshojë vendimin për mungesë të bazës ligjore, nga 9 në 3 vjet e gjysmë burgim të cilin do ta vuaj në burgjet e Prishtinës, Zagrebit dhe të Lubjanës.

Atëbotë, nga të gjithë të arrestuarit dhe gjykuarit ky ishte Grupi me nivelin më të lartë të shkollimit, prandaj dhe i referoheshin dhe si Grupi i intelektualëve.

Mr. Ukshin Hoti, përveç nivelit të lartë të përgatitjes profesionale (ishte Magjistër i Shkencave Politike dhe marrëdhënieve Ndërkombëtare), kishte qenë edhe në pozita të larta shtetërore.

Ishte themelues i Sekretariatit Krahinor për Marrëdhënie me Botën e Jashtme dhe Sekretar i këtij Sekretariati, i cili kishte vënë dhe bazat institucionale të bashkëpunimit të Kosovës me vende të ndryshme të botës e posaçërisht bashkëpunimit me Shqipërinë.

II

Biografi e shkurtër

Ukshin Hoti ka lindur më 17 qershor 1943 në Krushë të Madhe në komunën e Rahovecit të Kosovës. Është më i madhi prej 6 fëmijëve të prindërve të tij – Fatimesë dhe Nazifit. Shkollën fillore (8 vjeçare) e fillon në Krushë dhe e mbaron në Rogovë të Hasit. Në moshën 15 vjeçare, regjistrohet në Shkollën Normale të Prizrenit, ku kryen katër vitet e para. Ndërsa vitin V e kryen në Prishtinë. Më 1964, pas një viti që kishte ushtruar detyrën e mësuesit në Shkollën e vendlindjes së tij, regjistrohet, fillimisht në Fakultetin e Mjekësisë, e pastaj në atë të Shkencave Politike, në Zagreb. Pas përfundimit të studimeve, në vitin 1968, fillon studimet pasuniversitare në Beograd në drejtimin për Marrëdhëniet Politike dhe Ekonominë Ndërkombëtare. Nga viti 1969, fillon të shkruajë artikuj të ndryshëm në rubrikën e punëve të jashtme të gazetës Rilindja. Në shkurt të vitit 1970, ai angazhohet në administratën shtetërore, më saktësisht në Komisionin Ndërkombëtar për Bashkëpunim të LSPPJ (Lidhja Socialiste e Popullit Punonjës të Jugosllavisë) ku punon deri në maj të vitit 1972. Si zyrtar i kësaj administrate, ai delegohet për një mision paqeruajtës në Angolë për një periudhë 4 mujore.

Në prill të vitit 1972 emërohet Sekretar i Sekretariatit për Marrëdhënie me Botën e Jashtme, detyrë që do ta ushtroj deri me 1977. Po këtë vit, pasi fiton bursën «Fulbright», Ukshin Hoti shkon në Shtetet e Bashkuara për të vazhduar specializimin në Universitetin e Washingtonit, Çikagos dhe të Harvardit. Siç e ka bërë të njohur vet, në procesin e fundit gjyqësor kundër tij, me 1994, gjatë qëndrimit për specializim në SHBA ka gëzuar një trajtim jashtëzakonisht të lartë. Ka qenë i emëruar nga ana e rektorit të Universitetit të Harvardit si hulumtues shkencor i pavarur. Ka qenë i zgjedhur si i vetmi njeri që do të përfaqësonte të gjithë specialistët dhe postdiplomistët e Evropës në SHBA. Në këtë cilësi ka marrë pjesë në shumë dreka dhe bisedime që i organizonin senatorë e kongresistë të caktuar dhe përfaqësues të pushtetit në SHBA. Ka marr pjesë aktivisht nëpër simpoziume të ndryshme shkencore dhe nëpër ligjërime të intelektualëve autoritarë të SHBA.

„I kisha dyert e hapura për të gjitha kontaktet e mundshme dhe gëzoja shkallë të lartë të ndihmës teknike. [...] Mirëpo për të gjitha këto, për gjithë atë trajtim të lartë që m'u kishte siguruar atje, asnjëherë gjer më sot nuk e kam falënderuar qeverinë e SHBA-ve.”, thotë Ukshin Hoti para Trupit gjyqësor në Prizren, më 29 shtator 1994, për të vazhduar: „Prandaj, ndonëse duket e çuditshme për shkak të vendit dhe të kohës në të cilën po e bëj këtë, shfrytëzoj rastin që me gjithë zemër ta falënderoj qeverinë e SHBA-së për qëndrimin tim atje gjatë vitit shkollor 1977-1978”

Ishte ky gjykimi i tretë i tij, ku ishte dënuar me 5 vjet heqje lirie, për veprimtari armiqësore.

Para këtij, me 27 janar të vitit 1992, kishte organizuar një marsh protestues dhe përkujtues për 2 vjetorin e të rënëve në Brestovc të Rahovecit, për ç'rast dhe kishte përgatitur një analizë me titull „Bëje ose vdis!”, prej nga ka marr emrin dhe kjo ekspozitë. Për këtë shkak e kishin dënuar me 60 ditë heqje lirie „për shkak të prishjes së rendit dhe qetësisë publike”

Më 27 maj 1993, kishte shkuar, në Drenicë, për të vizituar të rrahurit nga policia. Në Drenas e ndalojnë së bashku me Agron Limanin dhe i rrahin deri në prag të vdekjes. Ukshini kishte dhe dy brinjë të thyera nga ai veprim i shkarjes së qenies njerëzore në nivel të bishës. Megjithatë, Ukshin Hotin nuk e ndalte vdekja.

Përkundrazi, ajo, për konceptin e tij politik ishte premisa për ta vrarë atë, prandaj, jo rastësisht, nga Burgu i Nishit, pas fillimit të luftës së UÇK-së, Ukshin Hoti do t'i referohet asaj disa herë, në formë të citatit të fjalëve të një drenicaku, në përgjigjet për pyetjet e Ismail Kadaresë: „Ne e dimë se të gjithë drenicakët janë të vdekur, por ashtu kemi

vendosur” për të vazhduar me komentin „se ka mundur lirisht të thoshte shumica absolute e shqiptarëve në Kosovë” në vend të shprehjes „drenicakët”.

Lufta e UÇK-së, Ukshin Hotin e kishte zënë në vuajtje të dënimit të retë prej 5 vitesh, dhe që andej, nga qelitë e burgut, ai nuk kishte hezituuar ta mbështeste atë.

Me 16 maj, një ditë para se të plotësonte vuajtjen e dënimit prej 5 vitesh, ditën e diele, jashtë çdo praktike, organet shtetërore të Serbisë e nxjerrin nga Burgu i Dubravës dhe nga ajo ditë nuk dihet për fatin e tij.

Odisejada e peripecive të rënda të këtij personaliteti nuk qëndron vetëm në vuajtjet e tij personale, por edhe të familjes. Vëllai i tij, më i vogël Afrimi, më 1981 ka qenë po ashtu i dënuar me burg. I ati, Nazifi, pas plagëve që kishte marr nga granatimet e ushtrisë serbe, vdes në pranverën e vitit 1999; vëllai i mesëm, Ragipi, ishte luftëtar i UÇK-së dhe bie në krye të detyrës dhe tani është dëshmorë i atdheut.

Duke qenë i tillë, Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës, në bashkëpunim me Kalanë e Tiranës, e panë të arsyeshme që të përgatisin dhe hapin këtë Ekspozitë në përkujtim të kësaj figure të veçantë të historisë sonë më të re dhe të 40 vjetorit të demonstratave të vitit 1981, kërkesat e të cilave, si asnjë tjetër i artikuloi dhe argumentoi Mr. Ukshin Hoti.

Mr. Bedri ZYBERAJ
Prishtinë, më 15.7.2021

THE CASE OF UKSHIN HOTI AND POLITICS IN HANDCUFFS



HOTI DHE ÇËSHITJA SHQIPTARE

POLITIKA NË PRANGA

A është Ukshin Hoti i burgosur politik, peng apo thjesht një rob lufte?

Ka 5-6 muaj që ka përfunduar shqyrtimi themelor gjyqësor i shkallës së tretë, (në Republikën e Serbisë - kushtetut supremë juridike, shën. im B.E.) i çështjes Ukshin Hoti, pas shqyrtjes së atëgjyqësor nga gjykatë e shkallës së dytë kundra tij, në shtator të vitit 1994, me të cilin ai dënohej me 5 vjet burg "për shkak të rezikimit të vendit kushtetues serb", përkatësisht, të sovranitetit serb mbi Kosovën, po megjithatë, që pundebari Ukshin Hoti nuk i është lejuar asnjë vendim me shkrim. Duke marrë për bazë paqëndrueshmëritë e plotë juridike të atëgjyqësoris, kemi asyqë të plotë të konstatojmë se Ukshin Hoti asnjëherë nuk është një i burgosur i rëndomtë politik në ish-Jugosllavi; ai tani mund të konsiderohet thjesht një rob lufte i Republikës së Kosovës ose një peng politik në duar e këlligurveve zyrtarë serbë "që në zgjedhjen e çështjes së Kosovës".

Kush është Ukshin Hoti?

Ukshin Hoti është i lindur në Krujë të Madhe, tash në komunën e Ra-hovecit, Republika e Kosovës, në vitin 1943 nga i ati Nasyri dhe e ëma Fatmja, në një familje me gjendje të mirë ekonomike (tubaj garazashin, ndërsa e ëma shpeshkalë). Vërtet, ai, në shkollën e parë publike serbe të Prizrenit, u cilësoi si "me gjendje të varfër ekonomike", që që i përgjigjet së vërtetë.

Nga fshati i tij radhet në moshën 12 vjeçarë për hir të shkollimit (8 vjet shkollë fillore, 5 vjet shkollë normale në Prizren e në Prishtinë, 4 vjet studime në Fakultetin e Shkencave Politike në Zagreb, 2 vjet studime postdiplomike në



Mr. Ukshin Hoti

HOTI DHE ÇËSHITJA SHQIPTARE

Beograd drejtimit i Marrëdhënieve Politike dhe Ekonomike Ndërkombëtare, pas të cilave specializon për një vit në universitetet amerikane të Çikagos, të Harvardit në Kembriç - Boston dhe në Washington D.C.)


Që nga gysma e dytë e viteve 70 gjer më 1981 ka punuar në detyra të ndryshme politike e arsimore në Kosovë; ka qenë ligjërues i vitit III dhe IV të Fakultetit Juridik, drejtimi Juridiko-Diplomatik, i vitit III të Fakultetit Filozofik, dega Filozofi-Sociologji, i shkollës politike të Qendrës Krahutore për Arsimimin Marksist "Edvard Kardel", ka qenë Sekretar i Sekretariatit për Marrëdhënie me Botën e Jashtme të KE dhe të Kuvendit të KSA të Kosovës, ka qenë anëtar i përbashkët të gjitha formave federale që merreshin me politikën ndërkombëtare.

Pas diskutimit të tij në një mbledhje të organizatës bazë partiake të Fakultetit Filozofik, dega Filozofi-Sociologji, në Prishtinë më 19 nëntor të vitit 1981, me ç'rast vihet në mbrojtje të hapur të studentëve, të demonstratave të tyre dhe të kërkuesve të tyre themelore për konstitucionin e Kosovës në Republikë, arrestohet dhe dënohet me 9 vjet burg, dënim i cili i ullet në 3,5 vjet nga Gjykata Supremen. Pas daljes nga burgu ai detyrohet të kthehet në fshatin e tij të lindjes në kushtet e një izolimi ostracit. Të gjitha përjekjet për shpërimin tregohen të pasuksesshme.

Më 1990 angazhohet në Lubjanë në revistat "Alternativa", "Republika" dhe në ato me titull "Demokracia Autentike - DEA" të cilën e drejton vetë si ideator politik dhe si kryeredaktor. Duke qenë se gazeta bllokohet me metodat finansiare të politikës së qeverisë të caktuara të Prishtinës, ai kthehet sërish në vendlindje nga ku vazhdon të veprojë herë me kontribute politiko-ekonomike, herë si profesor i Sociologjisë Politike në Universitetin e Prishtinës. Në fillim të vitit 1993 (në muajt mars-prill) e mban edhe forumin e tij të dytë politik për shkak se një vit më herët kishte organizuar një komand massiv për mburrjet e demokracisë në Brestovë. Po këtë vit ai rrabet për vdekje nga një priitë e njësitëve speciale serbë në Gillogovc, pas kthimit të tij nga vizita e grëvisëve të urisë në Pallatin e Shqypit në Prishtinë të inicuar nga Adem Demaçi.

Gjatë kësaj viti ai merr pjesë edhe në tubimet e organizuara në Tetovë me përfaqësues politikë gjithëkombëtarë ku merren qëndrime politike lidhur me nevojën e bashkimit të kombit shqiptar në një shtet unik. Në vazhdim e kësaj aktiviteti ai vihet në krye të partisë me program politik të bashkimit kombëtar UNIKOMB. Mërepo shteti, duke parë tek aktivizimin i tij i plotë politik rrezikon e prodhjes së baraspeshës politike dhe të marrëveshjes së heshtur me subjektin e pasivizimit politik shqiptarë të Kosovës, e burgos sërish më 17 maj 1994 dhe e dënon me 5 vjet burg nën proteksionin e "antitarafsimi legal në LPRK e në UNIKOMB me qëllim të minimimit të sistemit kushtetues e të tërësisë territoriale të Jugosllavisë".

Fillimi i jetëshkrimit të Ukshin Hotit



FORMIMI ARSIMOR DHE PUNA



Ukshin Hoti në ditën e diplomimit, Zagreb 1968




Ukshin Hoti me shokë , 1961



*Ukshin Hoti me nxënësit e tij
Viti shkollor 1963-1964 në fshatin Krushë e Madhe*



*Ukshin Hoti me shokë
në Kalanë e Prizrenit*



*Vendimi mbi përcaktimin e shumës së pagesës
për Ukshin Hotin
në pozitën e Sekretarit të Sekretariatit
për Marrëdhënie me Botën e Jashtme të KSAK-së*

GJYKIMI I GRUPIT TË INTELEKTUALËVE 1981



Nga e majta në të djathtë: Mentor Kaçi, Ukshin Hoti, Ekrem Kryeziu dhe Halil Alidema më 21 maj 1982.



Aktgjykimi P-nr. 73/82 i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë për grupin e intelektualëve



Ankesa e Ukshin Hotit kundër aktgjykimit P-nr. 73/82 të Gjykatës së Qarkut –Prishtinë



*„Duke qenë i vetëdijshëm plotësisht për rrethanat politike në të cilat ndodhemi, ftoj të formojmë politikë të qartë, mbi atë që duhet, dhe duhet, mendoj, në mënyrë urgjente, të formohen Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës”
Nga fjalimi i Ukshin Hotit në një tubim popullor në Fortesë - Rahovec, më 7.7.1991*


LAJMIRIM
27.01.1992. NORA 13” NF BASTOVIC DO P
NDERJME VENDIM RENJES SE DESHMOREVE
— DITEN KUR U LIND DEMOKRACIA.



*Në krye të marshit
për të përkujtuar „Dëshmorët e Demokracisë”
Nagavc, 27.1.1992*







Më 27.5.1993, Ukshin Hoti shkon në Drenicë për t'u informuar me situatën dhe me këtë rast ndalohet nga policia serbe dhe rrahët keq së bashku me Agron Limanin



Aktgjykimi Kp 13/96 i Gjykatës Federative mbi refuzimin e ankesës së Ukshin Hotit dhe konfirmimin e aktgjykimit K-28/94 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë

LETRA TË UKSHIN HOTIT NGA BURGU



DORËSHKRIME
TË
UKSHIN HOTIT

[illegible]

Frightlink

12-26-55

95

Shelton - Burma




LIBRA NGA DHE PËR UKSHIN HOTIN





UKSHIN HOTI NË FAQET E SHTYPIT

Shqiptarët janë popull i madh dhe se të drejtën e tyre për të qenë të vetes dhe që si të tillë t'i kontribuojnë qytetërimit të Evropës dhe botës, nuk mund t'ua mohojë dhe t'ua merr askush



Ukshin HOTI

EVROPA E BASHKUAR ME SHQIPTARËT E BASHKUAR

(Dokumenti që shërbeu si aktakuzë ndaj Ukshin Hoti)

Ukshin Hoti, viktimë e fundit e proceseve politike në Kosovë, u dënu me pesë vjet burg. Akaa kryesore kundër tij u bazua në projektdeklaratën politike që përgatiste ai si kryetar i UNIKOMB-it. Dokumentin jo e botojmë në tërësi, të vetëdijshëm se autoritetet serbe mund ta interpretojnë këtë akt si "shpërndarje të materialit armiqësor". Këtë e bëjmë nga motivet profesionale, por edhe nga bindja se liria e të menduarit dhe të shprehurit është vlerë esenciale për të cilën angazhohemi edhe ne si redaksi. Kjo është hera e dytë që z.Ukshin Hoti bie viktimë e shkeljes drastike të kësaj të drejte.

PROJEKTEDEKLARATË POLITIKE

Parimi i proklamuar gjatë fazës së krijimit të shteteve nacionale në Evropë NJË KOMB NJË SHTET APO KOMB I SHTET sipas së cilit pjesa apokaliptike në

e madhe a një popull përfaqëshe brenda kufijve nacionale të shtetit të vet /SHTET/KOMB/ me rastin e shqiptareve edhe përkundër vullnetit të tyre u implementuan pjesërisht: më tepër se gjysma e popullatës shqiptare dhe më tepër se gjysma e trojeve shqiptare mbetën jashtë kufijve të shtetit shqiptar.

Kjo u bë për shkak të synimeve të koncentruara grabitqare të forcave të caktuara politike në Ballkan, të adhimuara nga interesat kontradiktore të fuqive të mëdha të Evropës.

Konferenca e ambasadorëve të fuqive të mëdha në Londër e vitit 1912/13, pa përfaqësim adekuat dhe përkundër vullnetit politik të shqiptarëve në kryengritjet e vazhdueshme të atyre vites, e bëri aneksimin e kësaj ndarjeje të popullit shqiptar dhe të këtij copëti të trojeve të tyre duke u udhëhequr në besim se në atë mënyrë do të ruhej paqja e përgjithshme në prag të luftës së madhe botërore. Në vazhdimin e mëvonshëm të ngjarjeve, kjo çështje vazhdimisht qëndroi pezull e paqijshme me arsyetimin në kohë paqe se në atë mënyrë ruhej balanca e fuqive ndërkombëtare, kurse në kohë të krizave paqja e përgjithshme potenciale e krizave me

mundësinë e shfrytëzimit për shkatërrimin e tyre, por edhe për eskalimin në vatr aktuale të konflikteve të mundshme me përmasa të gjera.

III

Historia tani e ka konfirmuar në mënyrë decisive se shkelja e kësaj të drejte të popullit shqiptar dhe kurbanizimi i tij, për hir të paqes së përgjithshme, nuk shpëtoi ndonjëherë Evropën nga luftërat e mëdha apo të vogla të karakterit lokal. Shqiptarët nuk i mbajne çelësat për zhvillimin e raporteve midis popujve dhe kombeve rezikje të përshkrahjeve për destabilizimin e gjendjes i kontributojnë rendimit të situatave në kohë të caktuar, ngarkimi të vetëdijshëm kolektive të palëve të instaluar; eskalimit të dhunës dhe terrorit shtetëror gjër në përmasa tragjike dhe determinoi:

1) Ngacjen e vazhdueshme të popullit shqiptar në tërësi në të gjitha drejtimet

përkundër begatisë së bollshme natyrore me resurse natyrore dhe njerëzore;

2) Thellimin e vazhdueshëm të mosbesimit në raportet e gjithmbarshme midis shqiptarëve dhe fqinjve të tyre. Raportet shqiptaro-serbe, shqiptaro-malaziasë, shqiptaro-magedonase dhe shqiptaro-greke janë bërë të njohura historikisht si raporte konfliktuozë me shprehime të herëpashershme dhe në faktë të ndryshme, por akumulimi i mëtejshëm i konfliktueshmërisë në kontekst të përkulës së ngutit të vetëdijshëm kolektive mbi interesat e veçanta nuk mund të mbetet në vetë karakterin e këtyre raporteve dhe madje në vetë karakterin kolektive të këtyre popujve gjithëvë në bashku është dëshmuar me evidente se asnjë popull nuk mund të zhvillohet i lirë mbi supet e tjetrit.

IV

Duke e marrë parasysh shkallën e arritur të varesisë reciproke të shteteve dhe të

"DETYRA PATRIOTIKE NUK ËSHTË VEPËR PENALE"

Si u zhvillua gjykimi ndaj Ukshin Hoti, për çka u inkriminoi dhe si u mbrojt ai? Rrëfimin e kësaj nga avokati i z.Hoti.

popujve në Evropë dhe më gjerë në botë, faktin se historia e kombeve zhvillohet në ndërlidhje reciproke dhe se nuk është i mundur zhvillimi i izoluar i asnjë populli Partia e Unitetit Kombëtar vlerëson se zhvillimi i proceseve integruese dhe bashkimi i Evropës dhe krijimi i rendit të ri ndërkombëtar e ndihmuan angazhimin dhe luftën e hapur legale për bashkimin e shqiptarëve dhe të trojeve të tyre në një shtet të vetëm. Tendencia themelore që lidhet me proceset e tranzicionit demokratik në shtetet e Evropës Lindore dhe të ish-Jugosllavisë është pikërisht përfaqësimi i proceseve të krijimit të shteteve nacionale ose i pavarësisë së tyre. Bashkimi i Evropës përmes të realizimit të parimit KOMB/SHTET/ OSE NJË KOMB NJË SHTET ose bashkimi i Evropës përmes zbatimit të parimit të vetëvendosjes së popujve paraqitet si formulë e vetme e përshatshme për sigurinë dhe stabilitetin afatgjatë të Evropës së

bashkuar dhe për prosperitetin e popujve të saj UNIKOMB-i duke u angazhuar për zbatimin e këtyre parimeve ITË VETËVENDOSJES DHE TË KOMBIT/SHTET/ në rastin e shqiptarëve ndihmon në njëjtën kohë, avansimit të proceseve në fjalë të lidhura me bashkimin e Evropës dhe në ndërtimin e rendit të ri ndërkombëtar politik.

V

Duke u nisur nga këto parime UNIKOMB-i i nëbështet të gjitha aktet që kanë të bëjnë me krijimin dhe institucionalizimin e Republikës së Kosovës. Jetësimin e plotë të saj e shen në funksion të bashkimit të kombit dhe të proceseve integrative në Evropë. Kosova Republikë e pavarur është hallkë me rëndësi tranzitore drejt bashkimit përfundimtar të kombit për jo edhe përfundim i këtij procesi. Për këtë shkak ajo angazhohet njëkohësisht për inicimin, zhvillimin dhe forcimin e

atyre procese që çojnë drejt realizimit të këtij qëllimi si parti, do të investojë përpjekje dhe mund të duhur për përsosjen e vazhdueshme të organizimit të vetë në funksion të këtij qëllimi; për zhvillimin e atyre formave të demokracisë dhe të raporteve me forcat e tjera politike brenda dhe jashtë vendit që do t'i ndihmojnë funksionalizimit të këtij qëllimi. Parulla NJË KOMB, NJË SHTET MBETET DEVIZË KRYESORE E PUNËS DHE ANGAZHIMIT TË UNIKOMB-it GJERË NË REALIZIMIN E SAJ TË PLOTË NË KUSHTET DHE RREJTHANAT QË DO TA MUNDËSOJNË KËTË.

(Vërejtje:

Deklarata është e shkruar me dorëshkrimin e Ukshin Hoti dhe e njëjta i është marrë - gjetur në veturë me rastin e udhëtimit në Prishtinë kur dhe u arrestuar, më 15.05.1994)

„DEMOKRACIA” E UKSHIN HOTIT

Duket fare qartë se nuk është e mundur që shqiptarët vazhdimisht të viktimizohen; që me trupin e vet të sakatosur dhe me qenësinë e vet të rrezikuar në vazhdimësi, ta paguajnë çmimin e stabilitetit në Evropë!

Ukshin HOTI



„DEMOKRACIA” E UKSHIN HOTIT



Për krijimin e një Shqipërie etnike Lëvizja politike shqiptare nuk pat forca të mjaftueshme dhe as fizike për t'iu kundërvënë me një anë presionit fizik të sllavëve dhe, në anën tjetër, presioneve të ndryshme nga jashtë, që u manifestuan në dezorganizimin gati total të shoqërisë shqiptare.

Ukshin HOTI

Letra nga burgu



MENDIME PËR VEPRIMTARINË E UKSHIN HOTIT

Ismail KADARE

KUR MUNGON TIGRI, MAJMUNI BËHET MBRET



Emrin e Ukshin Hotit e kam ndeshur aty-këtu në shtypin e Kosovës, por për-herë në mënyrë të paqartë. Edhe kur merret në mbrojtje, edhe kur kërkohet lirimi i tij, kjo bëhet në mënyrë disi të ftohtë, si për një hije. Së paku në atë lloj shtypi që unë kam pasur rastin të lexoj.

Duke e ndjerë veten fajtor për një mosnjohje më të saktë të këtij personaliteti të rëndësishëm të popullit shqiptar, e vetmja gjë që për mua ka qenë e qartë sa po kam lexuar fragmentet e para nga mendimet e tij, ka qenë përgatitja e lartë profesionale. Kam frikë se pikërisht ky nivel i lartë ka qenë edhe burimi i fatkeqësisë që e ka ndjekur hap pas hapi këtë martir. Ka qenë tragjedi e vjetër e popujve ballkanikë, veçanërisht e shqiptarëve, përpjekja për të mënjeluar nga udhëheqja e një lëvizjeje, e një populli

apo shteti, njerëzit më të zotë.

Kur mungon tigri, majmuni bëhet mbret, - thotë një proverb kinez. Kjo logjikë e mbrapshtë, logjika e triumfit të mediokritetit, i ko shkaktuar, e, me sa duket do t'i shkaktojë ende dëme të ndjeshme çështjes shqiptare.

Ukshin Hoti duhet të dalë sa më par nga burgu. Është e papranueshme që një personalitet i një populli, pavarësisht ç'partie i përket ose nuk i përket, të mbahet në zingjirë. Është fyerje për krejt atë popull. Më fort se kurrë kombi shqiptar ka nevojë për njerëz të aftë e me nivel të lartë. Njerëzit e zotë janë princat e vërtetë të një kombi. Për fat të keq, princat goditen shpesh në mënyrë të vdekshme.

Nga një intervistë, 1996



Parathënie

Ky libër e ka rastitullën në përjetjen për lirinë nga burgu të Ukshin Hotit.

Pas dërgimit të një serie letrash institucioneve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, si dhe ministrave të punëve të jashtme të vendeve kryesore perëndimore, (bhej) fjale për një ish-kolegjin e tyre të rinë në fjalëzgjatë, u mendua se një libër në trajtë dialogu i botuar në një gjuhë shqipe, frëngjisht dhe anglishte, do të rritte më efikas për të lartësuar opinionin publik ndërkombëtar.

Ishte mesi i vitit 1997. Shqiptarja porta kishte dalë nga një dramë e shëmtuar veletarëse, në Kosovë rreth e zerrë dendësishin çdo ditë. Më tepër se kurrë, ndëgjë nevojë e prirjeve shqiptarë. Ndërkaj, Ukshin Hoti, qmën që ai fort i dëlëj Kosovës, gjesdë i lidhur me hekur.

Ky libër, pra u mendua si një thyeqje e këtyre hekurave. Roli i tij do të ishte i rrefatës: shpalja bërësish e përparimeve të Ukshin Hotit, apo që e kishin qenë në burg, ngjajë nevojë të tyre e kjoj dremës Kosovare, lirinë i lidhur. Dialogu me një

të burgosur, gjë e rëndësishme në çështjet demokratike, ishte i pamundur në një vend politizimit bërësish në Serbië. Ndaj u mendua si një dialog i rrefatës, i njohësish përpara pyetjeve të dremgata me aktrim. Ishte e natyrisht që ky aktrim të shpogohet nga autori i vazhdueshmë: do të arrihet dot pyetjet të ftohtë në burg? Do të arrihet dot pyetjet të dëlës?

Fjalë rrefatës dhe njërësive të guximshme, gjyryra e parë e mekulitsh ndodhi: pyetjet arrihen të i burgosur. Pas kësaj, e pabesuesishja (jo pabesuesish) pyetjet mësia të ditën. E gjithë ky kërkim një kohë tepër të gjatë. Një ngjashmësi mësia diktonë: rritin e këqaj bërës. Një ai rrefatës mekulitsh rritin mësia gjuhë. Duke e lexuar librin, lexuesi do ta ndiejë gjithmonë këtë mekulitsh. Pyetjet dhe pyetjet shpesh nuk përketet. Aty këtu ka dremat. Një ngjashmësi po të dëlës se librin ngjan herë-herë si i bombarduar. Shpjegimi është fare i thjeshtë: Ukshin Hoti i ka parë pyetjet vetëm pak kohë (me sa duket, dy tri muaj) këtu që pyetjet, të cilat me ai mund t'i t'i rrefatës, i ka hartuar sipas kujtesës. Në botimin "libri është respektuar ky vizion i të burgosur: pyetjet janë vënë bashkë, ndosht e ka lexuar, në atë ditë befasues kur i rrefatës në dorë, dhe pyetjet janë grumbulluar bashkë, mësia të i bërës pastaj në ditë e rrefatës të burgosur.

Një kohë më tej, ky libër po përjetohet me ngut, si dhe me ngutshëm, përpara gjithë bërës, për shpogohet tragjedia e Kosovës. Këtu mësia po arrihetshja përherë e një mësishja e pa mësish. Një mësia të rrefatës kësaj mësia të kësaj dremgata: lirinë i Ukshin Hoti, si që pyetjet të bërësish (bhej kësaj libër), kësaj rrefatës të dremgata përkrah pyetjet. Ky libër është tragjedia që i rrefatës ca kohë peng autorit e shpogohet bashkë me pyetjet e afërimit të Ukshin Hotit. E ngjashmësi pyetjet lirinë, kësaj mësia të dremgata mësia të shpogohet dremgata e mësishja. Aty i lidhur të Ukshin Hoti, librin gjuhë i mësishmë në kushte të rrefatës nuk është bërës mekulitsh, bërësish, rrefatës e ngjashmësi rrefatës e rrefatës, që fati i Ukshin Hoti u përkrahja e një mësish me fatin e kësaj Kosovës, që ka mësish vërtet lirinë martir. Fjalë bërësishmë i bërësish e bërësish me të, i Kosovës. Përkrah shpogohet, i ndërgjegjshëm se mësia i librit do të përkrahet tepër të shpogohet, pririmi lidhur të rrefatësish të bërësish e ngjashmësi dremgata e rrefatës të gjatë, për dyfish, dremgata, e ngjashmësi ata që kësaj librin të përkrah të bërësish rrefatës. E ndosht ta kësaj Ukshin Hoti. Si në një ngjashmësi, kësaj e ngjashmësi në të ngjashmësi, për të mësish gjuhë me të ngjashmësi të përkrah.

Aktiviteti mësia nuk e di që ka mësishmë të Ukshin Hoti. Një e dremgata të të mësish apo nuk

dremgata me të kësaj bërës. Bërës i dremgata, kësaj bërësish se ka qenë për herë të dremgata, i bërësishmë për dremgata. Thotet se mësia të mësia, një dremgata mësishmë të dremgata të bërës, i mësishmë, i shpogohet nga dremgata, për të qenë të dremgata të përkrahja. Thotet gjithë të qenë të përkrahja nga mësia.

Ky libër, gjithë rrefatës e ngjashmësi mësishmë, "bërësishmë" i të mësish me dremgata. Tani ai ka mësia të rrefatës bërësish, për ngjashmësi e dremgata të të përkrahja e mësishmë të mësishmë.

Këtë përkrahje pyetjet i Kosovës, rrefatës të bërësish pyetjet e mësia të rrefatës nga bërësish pyetjet nga Kosova, bërësish i dremgata i bërësish të pyetjet të rrefatës. Tani ai Fjalë bërësish, Admë Kësaj, mësia e mësia të pyetjet, një gjatë të përkrahja e ngjashmësi të dremgata, mësia mësia të kësaj të ngjashmësi ngjashmësi e bërësish.

Ukshin Hoti dremgata tani me bërësish. E në bërësishmë qenë të përkrah të bërësish të ngjashmësi, shpogohet, dremgata ngjashmësi të pyetjet, gjuhë ka bërësishmë bërësish, mësia bërësish ngjashmësi ngjashmësi të ngjashmësi të ngjashmësi. Ai dremgata të bërësishmë në kësaj ngjashmësi të librit e në bërësish të ngjashmësi të ngjashmësi të ngjashmësi të bërësish Kosovës, të shpogohet i përkrah e ngjashmësi të bërësish Kosovës.

Ismail Kadare
Tiranë, prill, 2000

MENDIME PËR VEPRIMTARINË E UKSHIN HOTIT

Dritëro AGOLLI

NJË PATRIOT I MADH QË I VË SUPET SHQIPËRISË




Ukshin Hoti është një nga politologët më të shquar të popullit tonë. Ai vetëm me këtë libër e ka treguar që është një filozof i vërtetë në problemet e politikës, por jo të një politike vulgare. Ai e shikon politikën në prizmin e filozofisë, dhe nxjerr konkluzione në bazë të fakteve konkrete dhe të historisë së popullit tonë. Ai nuk i trajton problemet historike dhe kombëtare thjesht në mënyrë deskriptive. Duke lexuar librin e Ukshin Hotit ti ndjen një thellësi të madhe të mendimit të tij, por njëkohësisht ndjen edhe një krenari që ka njerëz të tillë të shquar vendi ynë në të gjitha fushat e jetës. Por këtu, në këtë fushë, dmth. të filozofisë politike, unë nuk kam lexuar ndonjë të dytë që të jetë më i zoti se Ukshin Hoti.

Problemin e çështjes kombëtare ai e vështron në prizmin filozofik, në prizmin historik dhe në prizmin politik. Nuk thotë vetëm se si është Shqipëria, si është kjo çështja jonë kombëtare, por edhe se si mund të zgjidhet. Dhe kjo është nga meritat më të mëdha, sepse në shumë shkrime për problemet tona kombëtare tregohet vetëm se si ka qenë, sa i vjetër është populli ynë, me kë ka patur të bëjë, me përplasjet me fqinjët, me Evropën etj., por nuk jepen koordinata të sakta se ç'mund të bëhet që populli ynë të bëhet një popull i bashkuar, një komb jo i ndarë, jo i prerë me shpatë siç është sot Shqipëria. Dhe këtu qëndron merita më e madhe e Ukshin Hotit, pra në faktin që jep perspektivën se si duhet bërë... me një fjalë, ky libër është një program, nuk është thjesht një libër për filozofinë politike, por është si një program për shqiptarët, se si duhet të bëhet Shqipëria një vend me të vërtetë i evropëizuar. Ne flasim e themi se do të hyjmë në Evropë, do të evropëizojmë Shqipërinë, etj. Të gjitha këto janë fantazira, jonë gjysmake. Shqipëria evropëizohet kur të jetë një, e plotë, dhe jo kështu dy copësh, se kështu nuk evropëizohet kurrë. Kë do të evropëizosh ti, tre milionë banorë do të evropëizosh?

Po tre milionë të tjerë? D.m.th., problemi është tepër i ngatërruar për sa i përket evropëizimit të Shqipërisë, civilizimit të saj etj. Civilizim do të thotë kur të jesh një. Po s'që një nuk je i civilizuar plotësisht. Dhe Ukshini e trajton këtë problem.

Pastaj dhe një tjetër gjë: unë mendoj që njeriu mund të nxjerr konkluzione jo vetëm nga libri që kemi këtu përpara, po dhe nga gjithë aktiviteti i Ukshin Hotit, se ai nuk është vetëm një filozof, politikan i kabineteve, i zyrave e i arkivave, por ai është një njeri i aksionit, një njeri i luftës për një ideal të madh. Se ka lloj lloj filozofësh, politikanësh, historianësh, edhe ata kanë të drejtën e ekzistencës dhe nuk mund të them se nuk janë të shquar, por tek Ukshin Hoti bashkohen dituria, zgjuarsia filozofike me aksionin, me njeriun aktiv, me patriotin e vërtetë, jo thjesht një patriot librash, po një patriot i madh, që i vë supet Shqipërisë. Dhe fakti që gjendet në burg, dhe ka kohë që vuan burgimin e nuk del dot nga burgu, tregon se sa patriot dhe se sa njeri i lavdishëm është ai. Po ne shqiptarët fatkeqësisht njerëzit e shquar i kemi pak mëri, nuk i kemi aq shumë në përkrahje, ndonjëherë duam dhe t'i s'postojmë nga politika ose nga aktiviteti, siç është puna me Ukshin Hotin. Unë nuk mund të flas me kompetencë të madhe lidhur me mënjanimin e tij, por unë vë re një gjë, që për daljen e tij nga burgu nuk është bërë shumë në Shqipëri, as në Shqipërinë këtë Drinit, ku jemi ne, dhe as në Shqipërinë përtej Drinit, ku janë vëllezërit tanë.

RTSH, mars 1998



MENDIME PËR VEPRIMTARINË E UKSHIN HOTIT

Rexhep QOSJA

UKSHIN HOTI - SIMBOL I VETËDIJES HISTORIKE SHQIPTARE



Ukshin Hoti po bëhet ajo që ishte dhe është Adem Demaçi sot: simbol i martirizimit për lirinë e Kosovës, e kjo domethënë, simbol i qëndresës shqiptare. Kur është burgosur Ukshin Hoti, para disa vjetësh, gazetaret tona e kanë botuar lajmin me disa ditë vonësë. Mbasi që është burgosur Ukshin Hoti, edhe pse kuadër universitar, Universiteti ynë nuk e ko ngritur zërin kundër mbajtjes së tij në burg. Sot kanë ndryshuar punët. Sot Ukshin Hoti përmendet shpesh në shtypin tonë. Në Rektoratin e Universitetit të Prishtinës është mbajtur promovimi i librit të tij. Për të shkruhet gjithnjë e më shpesh. Diçka ka ndryshuar në shtypin tonë dhe në Universitetin tonë. Diçka po ndryshon në jetën tonë, në politikën tonë. Kemi filluar të vijmë në vete dhe këtë e dëshmon edhe qëndrimi ndaj Ukshin Hotit.



Ne po jetojmë "të lirë" nën pushtimin e Serbisë e Ukshin Hoti po vuan burg! Ne po stolisemi me stoli pushtetore - "president", "deputet", kryetar partie; e të tjera, nën pushtimin serb, e Ukshin Hoti po bën burg Serbie! Ne për lirinë e Kosovës po "luftojmë", duke marrë rroga, duke u vozitur me vetura luksoze, duke pritur e përcjellë mysafirë me dreka e darka zyrtare - si paraardhësit tonë politikë komunistë, e Ukshin Hoti po dënohet me burgje, për shkak të përpjekjeve për lirinë e Kosovës! Me mbajtjen në burg të Ukshin Hotit dhe të të burgosurve të tjerë politikë, regjimi serb dëshiron ta arrijë sot, atë që synonte ta arrinte me mbajtjen në burg të Adem Demaçit dhe të të burgosurve të tjerë politikë!

Mbajtja e Ukshin Hotit dhe e bashkë-mendimtarëve të tjerë në burgjet e Serbisë e rëndon shumë ndërgjegjen e njeriut tonë politik sot, dhe i qet hije të rëndë politikës që bëjnë bashkimet tona politike. Dëshëm s'dëshëm ta pranojmë, Ukshin Hoti - ky sot është simbol i vetëdijes historike, i ndërgjegjes dhe i qëndresës së pamposhtur shqiptare. Nuk është e çuditshme pse ky është emri më i kuptimshëm, më domethënës, më frymëzues në jetën tonë politike sot. Dhe kjo tregon se populli ynë e çmon ashtu siç duhet njeriun e gatshëm për sakrificë.

Dua të besoj se Ukshin Hoti do të dijë ta mbajë si duhet domethënien gjithëkombëtare që e rrezaton sot emri i tij.

Nga një intervistë, 1998

Nuk mund të kuptoja se lufta për shtetin e Kosovës mund të zhvillohej duke e penguar daljen time nga burgu!

UKSHIN HOTI

Letra nga burgu

MENDIME PËR VEPRIMTARINË E UKSHIN HOTIT

Agim VINCA

NJERIU ME «UNË» TË MADH

Me njeriun që na ka tubuar sonde këtu (sikurse edhe mbrëmë dhe në netët vijën), Mr. Ukshin Hotin, nuk kam pasur raporte të afërta miqësore, por kam pasur respekt - e kam çmuar gjithmonë - për qëndrimin e tij dinjitoz e konsekuent në jetë dhe në krijimtari. Them edhe në krijimtari, sepse Ukshini është publicist, eseist, politolog...

Është hera e tretë që Ukshin Hoti bie në burg (herën e parë pas vitit 1981), kurse «ndeshjet» e tij me policinë serbe kanë qenë edhe më të shpeshta. Përse? Për shkak se policia serbe dhe pushteti të cilit i shërben ajo e dinë fare mirë se cili është jonë kundërshtarët e tyre të vërtetë në mesin e shqiptarëve.

Miku dhe kolegu ynë, Ukshin Hoti, tash sa muaj ndodhet në burg. Së shpejti pritet gjykimi dhe ndoshta (me siguri) edhe dënimi i tij dhe jemi mbledhur të protestojmë kundër këtij gjykimi absurd e të kërkojmë lirimin e tij. Po prej kujt? Prej gjyqit serb, që është instrument në duart e okupatorit. Kështu e kemi ne. Ndodh që të kujtohem për njerëzit tanë kur ikin, kur bien në burg, kur largohen (jo rrallë as në raste të tilla!), ndërsa kur i kemi pranë i fyejmë, i rrethojmë në heshtje, i injorojmë, i nënçmojmë, i linçojmë... Edhe pse nuk kam pasur kontakte të shpeshta me të, Ukshini më është dukur viteve të fundit disi i vetmuar, i izoluar, i braktisur, i harruar dhe ngapak i frustruar.

Ukshin Hoti është nga ata njerëz që i stolisin karakteri, krenaria, kryelartësia. Ai është njeri që ka «Unin» e vet me «U» të madhe. E kjo nuk është pak. E vlen të jesh i tillë në jetë, edhe pse kushton shtrenjtë.

Intelktual me koncepte të qarta e përkushtim të lartë ndaj kombit, shtetit, politikës, demokracisë, në shkrimet dhe paraqitjet e tij, veçmas në revistën «DeA»,

ai u angazhua me të drejtë, siç e thoshte edhe titull i saj, për një demokraci autentike; për një demokraci në kushtet shqiptare, ashtu siç u angazhua edhe për një politikë unike e me strategji të qartë kombëtare.

Për intelektualët dhe veprimtarët si Ukshini ekziston patria (d.m.th. Atdheu) pastaj partia; ekziston kombi pastaj demokracia. Sepse, demokracia po kombin është si lulja në trupin e të vdekurit, ka thënë një poet.

Prishtinë, 24.09.1994



MENDIME PËR VEPRIMTARINË E UKSHIN HOTIT

Mahmut BAKALLI

ISHTE I NGARKUAR QË TË FORMONTE NË KOSOVË DIKASTERIN E PUNËVE TË JASHTME



Me Ukshin Hotin jam mik e shok që nga rinia e hershme. Ai është më i ri se unë, prandaj mua nuk më takon të flas për të me patetikë, por ashtu realisht, siç flet njeriu për të afërmin e vet, me fjalë të matura e të duhura.

Ukshin Hotin e karakterizon vërtet një inteligjencë e rrallë, një zgjuarsë, personale e cila më së miri ka ardhur në shprehje në shkencat politike.

Ukshin Hoti është një profil i posaçëm i intelektualit shqiptar të shkencave politike. Ai nuk e kupton politikën si makiavelizëm, d.m.th., si veprim ku nuk zgjidhen mjetet për të arritur qëllimet e për të ardhur në pushtet. Por tek Ukshin Hoti politika disi është tepër e ngarkuar me moralizim. Kjo është vlera kryesore e tij në kuptimin e politikës, por pikërisht në këtë vlerë qëndron edhe dobësia e të kuptuarit të politikës nga Ukshini. Duke e moralizuar politikën, ai ndonjëherë humb rezistencën ndaj disa sfidave, që domosdo i sjell politika dhe që e përcjellin politikën, dhe nganjëherë nuk i kupton mjaft edhe disa ndërskamca, dredhi e provokime që i sjell ajo, prandaj tek ai nganjëherë shfaqet dëshpërimi e resignacioni në vend të kacafytjes me problemet politike.

Ukshin Hoti është dhe një patriot i madh shqiptar. Një patriot jo folklorik, jo atavist, por një patriot shqiptar i qytetëruar, modern, sepse



kombit shqiptar i qaset si një kombi modern, një kombi të qytetëruar evropian.

Ukshini posaçërisht e ka të zhvilluar sensin për diplomaci dhe për marrëdhënie ndërkombëtare. Derisa isha udhëheqës i Kosovës, Ukshini ishte i ngarkuar që të formonte në Kosovë dikasterin e punëve të jashtme. Ai atë e bëri me sukses. Sekretariati Krahinor i Punëve të Jashtme ka vepruar nën udhëheqjen e tij vite me radhë me suksese të mëdha, me kontakte të ndryshme të diplomatëve e të delegacioneve të huaja, si dhe të shkuarjes së kosovarëve si delegacione në botën e jashtme.

(RTSH, qershor 98,

nga Dokumentari TVSH për U. Hotin)



Informatë mbi bashkëpunimin teknik me botën e jashtme

*Përgatitur nga Ukshin Hoti,
më 14.5.1973*



Ukshin Hoti me mision paqeruajtës në Angola të Afrikës, 1972

MENDIME PËR VEPRIMTARINË E UKSHIN HOTIT

Esat STAVILECI


NJOHËS I MIRË I SISTEMEVE POLITIKE DHE MARRËDHËNIEVE NDËRKOMBËTARE




Kemi të bëjmë me një emër të intelektualit që sugjeron guximin politik, një emër të një eseisti politik që sjell shprehjen kompetente profesionale, që nxit fuqinë e të menduarit, ndërsa kur flasim për veprën e tij, kemi të bëjmë me një vepër të një njohësi të mirë të sistemeve politike e të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe për një vepër të historianit të çështjes shqiptare. Me këtë rast do të theksoj

angazhimin e Ukshin Hotit për t'i dalë zot kauzës kombëtare, me gjerësinë e shtruarjes së çështjes së Kosovës dhe të çështjes shqip tare në përgjithësi. Pastaj më duhet të theksoj argumentimin e tij të bollshëm e profesional me themelësi politike, pse Kosova është dhe duhet të jetë republikë. Theksoj mbrojtjen e tij brilante, në mënyrë të veçantë, që i bëri para gjyqit qenies së Kosovës republikë mbi parimin e së drejtës së vetëvendosjes. Theksoj premisat e filozofisë politike në veprën e tij, dhe më në fund theksoj mendimin e tij të mëvetësishëm, autentik, në rrahjen e çështjes kombëtare shqiptare që emrin dhe figurën e tij e bëjnë sui generis, d.m.th. të një lloji të veçantë. Prandaj është fjala për një emër dhe një vepër të cilën duhet ta përkujtojmë.

(RTSH, qershor 98, nga dokumentari për
U. Hotin)



Teza e bashkëpunimit
në mes RP të Shqipërisë dhe Kosovës
Përgatitur nga Ukshin Hoti,
më 20.11.1974



SHTËPIA MUZE E UKSHIN HOTIT - KRUSHË E MADHE

